




INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË PUBLIKE TË KOSOVËS



SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME INFLUENCË, COVID-19 DHE PATOGENËT TJERË RESPIRATORË NË KOSOVË, SEZONA 2025/2026 (JAVA 15-TË)

Simptomet e Gripit përfshijnë:

- Temperaturë/ethe
- Kokëdhimbje
- Lodhje
- Kollë e thatë
- Dhimbje fyti
- Rrjedhje hundësh
- Dhimbje muskulare
- Simptome gastrointestinale, si nauze dhe barkqitje




PËRMBLEDHJE

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike gjatë tërë vitit bën mbikëqyrjen permanente të Influcencës sezonale (ILI), ARI dhe SARI me intensifikim të aktiviteteve gjatë sezonës përkatëse. Mbikëqyrja realizohet përmes hulumtimit aktiv dhe pasiv në institucione shëndetësore dhe terren.

**SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME INFLUENCËN SEZONALE NË KOSOVË,
2021/2022 - 2025/2026**

Sipas grafikoni 1, ku janë paraqitur rastet e Influencës sezonale (ILI) në 5 sezonat e fundit shohim se sezona 2025/2026 karakterizohet me numër më të ulët të rasteve të raportura, krahasuar me periudhën e njëjtë të sezonës 2024/2025 dhe fillim të aktivitetit nga java e 40-të e sezonës 2025/2026.

Grafikoni.1



**SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME INFLUENCËN SEZONALE NË KOSOVË, 2025/2026
DHE PRAGU EPIDEMIK**


Nga fillimi i sezonës, 29 shtator 2025 deri më 12 prill 2026 (java e 15-të) në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës janë raportuar 52,128 raste të Sëmundjes të ngjashme me Grip (ILI), 8,784 raste të Infeksioneve respiratore akute (ARI) dhe 230 raste me Infeksion të rëndë respirator akut (SARI).

Gjatë javës së 16-të (06.04.2026-12.04.2026) janë raportuar 852 raste ILI (Sëmundje e Ngjashme me Gripin), 250 raste ARI (Infeksion Respirator Akut) dhe 2 raste SARI (Infeksion i Rëndë Akut Respirator).

Përmes sistemit të mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse dhe paralajmërimit të hershëm (SMSN) janë raportuar 235 raste ILI, 25 raste ARI dhe 2 raste me SARI.


Intensiteti i Influencës sezonale sipas numrit të rasteve të raportuara për javën e 15-të paraqitet në aktivitetin e ulët të qarkullimit dhe krahasuar me javën e kaluar shënon rënie prej 29%. (Graf.2)


Grafikoni.2



Në grafikonin 3 shohim se në të gjitha komunat janë raportuar raste të dyshimta në Influencë dhe sipas numrit të rasteve të raportuara, numër më të lartë kanë komuna e Prishtinës, Mitrovicës, Pejës dhe Prizrenit ndërsa sipas Incidencës numër më të lartë të rasteve kanë komuna e Kamenicës dhe Suharekës.


Grafikoni.3





Në raport me distribuimin e rasteve sipas grup-moshës dhe incidencës, nga numri total i rasteve të raportuara me ILI, shihet se të gjitha grup-moshat janë të atakuara derisa sipas Incidencës; grup-mosha 0-4 dhe mbi 65 vjeç. Sa i përket rasteve me ARI, grup-mosha më e atakuar është 0-4 vjeç (6,265 raste) pastaj grup-mosha 5-14 vjeç (1,152 raste), 15-64 vjeç (930 raste), dhe grup-mosha 65+ vjeç (437 raste). (Graf.4)


Grafikoni.4



MBIKËQYRJA VIROLOGJIKE


Në laboratorin e Qendrës Kombëtare të Influcencës – IKSHPK nga fillimi i sezonës 2025/2026 deri më 15 prill 2026, janë testuar gjithsej 4,243 mostra nga pacientët e qendrave sentinel dhe jo sentinel si raste të dyshimta në ILI, ARI dhe SARI. Nga mostrat e testuara 2,124 (50.1%) prej tyre të dyshimta në SARS-CoV-2 dhe 2,119 (49.9%) të dyshimta në Influcencë dhe patogjenët tjerë respiratorë. Gjatë kësaj periudhe në SARS-CoV-2 janë konfirmuar 21 raste (0.9%). Nga 2,119 mostrat e testuara në Influcencë dhe patogjenët tjerë respiratorë janë konfirmuar 335 raste me Influcencë A dhe B (pozitiviteti 15.8%), prej tyre 332 apo 99.1% me Influcencë A dhe 3 apo 0.9% me Influcencë B. Rastet e konfirmuara me Influcencë A dhe B janë nga komuna e Prishtinës (128 raste), Mitrovicë (58 raste), Fushë Kosovë (24 raste), Ferizaj (13 raste), Podujevë (14 raste), Malishevë (14 raste), Lipjan (12 raste), Vushtrri (10 raste), Drenas (8 raste), Kaçanik (6 raste), Skenderaj (6 raste), Gjakovë (5 raste), Viti (5 raste), Suharekë (5 raste), Gjilan (4 raste), Pejë (4 raste), Shtime (3 raste), Klinë (3 raste), Rahovec (2 raste), Graçanicë (2 raste), Kamenicë (2 raste), Prizren (2 raste) dhe me nga 1 rast komunat : Novobërdë dhe Obiliq dhe i takojnë grup-moshës 0-4 vjeç (153 raste), 5-14 vjeç (87 raste), 15-34 vjeç (37 raste), 35-50 vjeç (15 raste), 51-64 vjeç (13 raste) dhe 65+ (30 raste). Gjatë javës së pesëmbëdhjetë (06.04.2026-12.04.2026), nga labororet private janë raportuar gjithsej 28 mostra të testuara si të dyshimta në SARS-CoV-2. Nga këto mostra nuk është konfirmuar asnjë rast pozitiv. Nga patogjenët tjerë respiratorë, janë konfirmuar: 260 mostra me RSV, 434 mostra me Human Rhinovirus, 207 mostra me Human Adenovirus, 76 mostra me Metapneumovirus dhe 54 mostra me Parainfluenza Virus (Graf.5). Rastet pozitive në RSV (12.3%), janë nga komuna e Prishtinës (96 raste), Fushë Kosovë (34 raste), Ferizaj (23 raste), Malishevë (15 raste), Podujevë (15 raste), Vushtrri (9 raste), Lipjan (7 raste), Gjilan (6 raste), Suharekë (6 raste), Obiliq (6 raste), Drenas (5 raste), Prizren (5 raste), Viti (4 raste), Kaçanik (4 raste), Mitrovicë (3 raste), Shtime (3 raste), Rahovec (3 raste), Hani i Elezit (2 raste), Kamenicë (2 raste), Klinë (2 raste), Deçan (2 raste) dhe me nga 1 rast komuna: Graçanicë, Gjakovë, Istog, Novobërdë, Skenderaj dhe Pejë. Rastet pozitive me RSV i takojnë grup-moshës 0-4 vjeç (229 raste), 5-14 (15 raste), 15-34 (5 raste), 35-50 (1 rast), 51-64 (2 rast) dhe 65+ (8 raste) (Graf.5).

Grafikoni.5



Sipas subtipit: me subtipin AH3: 32 mostra apo 10%, me subtipin AH1N1: 12 mostra apo 3%, Influcencë A të pa subtipizuar, 288 mostra apo 87% dhe Influcencë B, 3 raste apo 1%.(Graf.6.)

Grafikoni. 6



AKTIVITETET SEZONALE

IKSHPK/Departamenti i Epidemiologjisë bënë mbikëqyrjen e Influcencës gjatë tërë vitit, me intensifikim të saj gjatë sezonës përkatëse (java e 40 deri në javën e 20).

Përcjell situatën epidemiologjike me rastet ILI/ARI (javore) dhe rastet me SARI (në bazë ditore/alerti).

Bënë testimin laboratorik të mostrave në Departamentin e Mikrobiologjisë/Qendrën Kombëtare për Testimin e Influcencës.

Ka dhënë këshilla për popullatën për mbrojtjen nga sëmundja dhe njohjen e simptomeve të saj.

MASAT PËR PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË VIRUSIT TË GRIPIT SEZONAL

Aktiviteti i gripit për sezonën 2025/2026, është në nivel më të ulët krahasuar me sezonën paraprake dhe masat për parandalimin dhe kontrollin e infeksioneve respiratore janë:

Mbajtja e maskave.

Distanca fizike.

Higjiena e duarve.

Evitimi i kontakteve të afërta me individë të sëmurë.

Redukimi i vizitave të familjarëve tek personat e hospitalizuar (SHSKUK, Spitalet rajonale).

Evitimi i vendeve të mbyllura dhe të mbingarkuara me njerëz.

Ushqimi i shëndetshëm me shumë vitamina.

Aktiviteti fizik dhe gjumë i mjaftueshëm.

Personat e sëmurë të qëndrojnë në shtëpi.

- Pastrimi dhe dezinfektimi i mjediseve ku qëndroni.
- Mbulimi i hundës dhe gojës me një shami gjatë teshtitjes dhe kollitjes si dhe hudhja më pas në vend të sigurt.
- Larja e duarve shpesh me ujë dhe sapun, ose solucione duarsh me alkool.
- Sytë, hunda dhe goja të mos preket me duar të kontaminuar, pasi virusi përhapet në këtë mënyrë.
- Pastrimi dhe dezinfektimi i sipërfaqeve dhe objekteve që mund të jenë kontaminuar nga virusi.

Konsultimi me mjekun për mjekimin me barna kundër gripit, të cilat duhet të merren vetëm me rekomandimin e mjekut

Medikamentet kundër gripit duhet të fillohen brenda 48 orëve të para të fillimit të sëmundjes për të pasur efektivitet të lartë.

Ato mund të parandalojnë edhe komplikimet e rënda që mund të vijnë nga gripit.

Mënyra më efikase për parandalimin e virusit të gripit është Vaksinimi me vaksinën kundër gripit.

- Vaksinimi mbron vetë personin dhe ndihmon në parandalimin e përhapjes së gripit.
- Efekti i vaksinës fillon 1 deri 2 javë pas marrjes dhe mbrojtja vazhdon rreth një vit pas vaksinimit.

VAKSINIMI

Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me IKSHPK në fillim të sezonës së gripit 2025/2026 ka siguruar 85,000 doza të vaksinës sezonale dhe me fillimin e sezonës ka filluar vaksinimi sipas rekomandimeve. Deri më 31 janar 2026 janë administruar gjithsej 67,072 doza të vaksinës kundër gripit sezonal. Prej tyre sipas grupeve të rrezikut: 44,752 janë administruar te grup-mosha mbi 65 vjeç, 20,467 me sëmundje kronike, 1,300 profesionistë shëndetësor, 6 gra shtatëzëna, 49 fëmijë (0-5 vjeç), 195 zyrtarë policorë dhe 32 mësimdhënës dhe të tjerë 271.

HOSPITALIZIMET

Gjatë javës së fundit nga rastet e hospitalizuara në Klinikën Infektive, Klinikën e Pediatriisë dhe spitalet rajonale janë raportuar 37 raste me ARI, 1 rast me ILI dhe 2 raste SARI.

Nga Klinika Infektive deri më 12 prill 2026, janë raportuar 5 raste të vdekjes me Influcë A. Tre nga rastet i përkasin gjinisë mashkullore dhe dy gjinisë femërore; 4 prej të cilëve i takojnë grup-moshës mbi 65 vjeç dhe një prej tyre grup-moshës 35-50 vjeç dhe me sëmundje kronike përcjellëse.

SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE NË RAJON DHE EVROPË**INFLUENCA SEZONALE JAVA 15/2026 NË EVROPË**

Aktiviteti i infeksioneve respiratore në rajonin evropian paraqitet përgjithësisht në nivele të ulëta ose ndërsezonale. Trendi i sëmundjes së ngjajshme me gripin (ILI) është mbi nivelin bazë vetëm në Romani, ndërsa asnjë vend nuk ka raportuar rritje të infeksioneve akute respiratore (ARI). Qarkullimi i virusit të gripit ka rënë nën pragun epidemik, me një pozitivitet rreth 5%, duke reflektuar aktivitet të kufizuar sezonal. Në mostrat e analizuara dominojnë viruset e tipit A, me nën-tipe të përziera A(H3) dhe A(H1)pdm09. Intensitet mesatar ose më i lartë i gripit është raportuar vetëm në Poloni dhe Turqi, ndërsa shpërndarje rajonale ose të gjerë është evidentuar në një pjesë të kufizuar vendesh. Aktiviteti i COVID-19 (SARS-CoV-2) mbetet në nivele bazë, me pozitivitet të ulët dhe pa sinjale për rritje të transmetimit, ndërsa mortaliteti i lidhur me COVID-19 vazhdon të jetë i ulët, përfshirë edhe grupmoshat ≥ 65 vjeç. Në të njëjtën kohë, virusi respirator sincicial (RSV) vazhdon të ketë pozitivitet relativisht më të lartë (~10–12%), por me trend të qëndrueshëm në rënie si në numrin e testeve ashtu edhe në rastet e detektuara. Nga perspektiva e ashpërsisë, të dhënat nga rastet e rënda (SARI) tregojnë nivele të ulëta të pozitivitetit për gripin, SARS-CoV-2 dhe RSV, pa indikacione për rritje të barrës klinike. Shkalla e vdekshmërisë së tepërt nga të gjitha shkaqet në nivel rajonal mbetet brenda pritshmërive për të gjitha grupmoshat, pa evidencë për rritje të tepërt. Në tërësi, situata epidemiologjike karakterizohet nga aktivitet i ulët i viruseve respiratore dhe mungesë e presionit të shtuar mbi sistemet shëndetësore.

Burimi: <https://erviss.org/>